

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                           |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Hoxha: Shqipëria, e gatshme ta luajë rolin e vet përkrah SHBA-së për paqe në Gazë                         |
| ADRESA  | https://dosja.al/aktualitet/hoxha-shqiperia-e-gatshme-ta-luaje-rolin-e-vet-perkrah-shba-se-per-pa-i513131 |
| BURIMI  | dosja.al                                                                                                  |
| GJENDJA | online                                                                                                    |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                          |
|-----------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 13 shtator 2026, 19:32:39 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                           |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 16:34:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 221afa7df97b6d5e6e9d1d2e0f16758d02e6e5ceca453dcb58993d17f9c776ec |
| TEKSTI     | a7a6f2b09053fb4b9dded1490445412713ba77ba88594c8a261039d0d9c5618b |
| PAMJA      | 3de6fec3c18c629438cf8760c367992ae5a4c08fed54e8defea07ebca3456850 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | f357336182a484a949abd43b2eef15602426313b5a26d5b55039985df9ef4212                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f357336182a484a949abd43b2eef15602426313b5a26d5b55039985df9ef4212>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





## LIVE UPDATES ▾

2 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

3 ORE ME PARE

Reforma e re territoriale/ Rama përplaslet me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

9 ORE ME PARE

Të shtëna me armë zjarri në Mat/ Gjendet e djegur makina e autorëve, shënjestra ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba

9 ORE ME PARE

"Vetë zot, vetë shkop"/ Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, shpërthen Rama: Do nxirrnin dhëmbët për të shumëfishuar rrogat! KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

## Aktualitet

## Hoxha: Shqipëria, e gatshme ta luajë rolin e vet përkrah SHBA-së për paqe në Gazë

Ai theksoi se si anëtare themeluese e Bordit të Paqes, Shqipëria është e vendosur të luajë rolin e saj përkrah Shteteve të Bashkuara dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë në mbështetjen e përpjekjeve për të krijuar kushtet për siguri, stabilitet dhe paqe të qëndrueshme në Lindjen e Mesme.



8 Shtator 2026, 18:34  
Nga G.M



Gjeneralmajor Jasper Jeffers, komandant i Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese për Gazën, dhe ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ferit Hoxha, në Tiranë, Shqipëri, më 8 shtator 2026.

Gjeneralmajor Jasper Jeffers, komandant i Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese për Gazën, dhe ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ferit Hoxha, në Tiranë, Shqipëri, më 8 shtator 2026. Shqipëria është e përgatitur për të kontribuar në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese (ISF) në Rripin e Gazës, si dhe për të luajtur rolin e saj përkrah Shteteve të Bashkuara për paqen dhe sigurinë, tha të martën ministri i Jashtëm, Ferit Hoxha.

Hoxha i bëri këto komente pas një takimi në Tiranë me gjeneralmajorin amerikan Jasper Jeffers, i cili është komandant i ISF-së. Jeffers qëndroi për një vizitë në Shqipëri, ku u takua edhe me ministrin e Mbrojtjes, Ermal Nufi. Hoxha tha në një shkrim në X se bisedoi me Jeffersin për rëndësinë e pjesëmarrjes së Shqipërisë në ISF dhe gatishmërinë për të kontribuar aty ku përpjekjet ndërkombëtare mund të sjellin ndryshim.

Ai theksoi se si anëtare themeluese e Bordit të Paqes, Shqipëria është e vendosur të luajë rolin e saj përkrah Shteteve të Bashkuara dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë në mbështetjen e përpjekjeve për të krijuar kushtet për siguri, stabilitet dhe paqe të qëndrueshme në Lindjen e Mesme.

*"Kontributi ynë në ISF është një vazhdim i natyrshëm i këtij angazhimi dhe i besimit tonë se vendet, pavarësisht nga madhësia e tyre, mund të japin kontribute domethënëse në adresimin e sfidave të kohës sonë", deklaroi Hoxha.*

Edhe ministri Nufi theksoi gatishmërinë e Shqipërisë për të dhënë kontribut në misione të përbashkëta ndërkombëtare, duke e lidhur pjesëmarrjen në ISF me partneritetin strategjik Shqipëri-SHBA dhe bashkëpunimin në kuadër të NATO-s. Shqipëria ishte ndër vendet e para që u zotua për të dërguar trupa në kuadër të këtij misioni në Gazë. Në fillim të këtij viti, një ekip i ushtrisë shqiptare ishte dërguar në Gazë për të parë nga afër aiendien në

## editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet  
kërkuar tek revolta e  
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

## Në vëmendje

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 12:07

Analiza: Si po përdoret IA-ja  
për sigurinë në shkollat e  
Shqipërisë

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 09:45

Detaje nga të shtënat me armë  
në Mat/ Reth 30 gëzhoja  
gjenden në vendngjarje,  
pronarët e mjetit të djegur  
sapo ishin kthye nga Italia

teren.

Asokohe, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura pati thënë se kontingjenti i parë shqiptar që mund të dërgohej në Gazë do të ishte pjesë e shtabit të ISF-së, ndërsa më pas do të shqyrtohej një kontribut më i gjerë me trupa. Jeffers vizitoi Shqipërinë një ditë pasi ishte në Kosovë, ku së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtnant Bashkim Jashari, nënshkruan një marrëveshje që formalizon përfshirjen e Kosovës në ISF.

Edhe Kosova kishte dërguar në fillim të vitit ekip në Gazë për ta vlerësuar terrenin para zhvendosjes së trupave atje. Deri tani, përvec Kosovës dhe Shqipërisë, dhe Indonezia, Maroku dhe Kazakistani i janë bashkuar ISF-së, ndërsa Egjipti dhe Jordania janë zotuar ta trajnojnë policinë.

Forca Ndërkombëtare Stabilizuese buron nga një plan 20-pikësh i presidentit amerikan, Donald Trump, për t'i dhënë fund luftës së Izraelit në Gazë. Trumpi krijoi Bord të Paqes për të mbikëqyrur planin e tij për t'i dhënë fund luftës së Izraelit në Gazë dhe për të rindërtuar territorin e shkatërruar.

Sipas planit, forca paqeruajtëse duhet të zhvendosen në Gazë për të siguruar zonat pas tërheqjes së forcave izraelite, si dhe t'i trajnojnë forca e reja policore palestineze dhe të mbështesin dërgimin e ndihmave atje. Pjesa më e madhe e Gazës mbetet në rrënoja pas dy vjetësh luftë, e cila u shkaktua nga sulmet e udhëhequra nga Hamasi ndaj Izraelit më 7 tetor 2023. Hamasi është grupi i shpallur terrorist nga SHBA dhe BE.

Por, që nga njoftimi për një marrëveshje në fund të korrikut, përpjekjet për dërgimin e trupave kanë ngecur, pasi si Izraeli, ashtu edhe Hamasi nuk kanë pranuar t'i përmbushin kushtet që do ta mundësonin zbatimin e marrëveshjes. I dërguari i Trumpit dhe dhëndri i tij, Jared Kushner, zhvilloi takime të ndara me zyrtarë të Hamasit dhe me udhëheqës izraelitë në gusht, por u largua pa ndonjë përparim, pasi të dyja palët qëndruan të palëkundura në kërkesat e tyre kryesore.

Prandaj, mbetet e paqartë se kur do të mund të dërgohen trupat e misionit ndërkombëtar në Gazë. Plani i armëpushimit e ka ulur dhunën në Gaza, por nuk i ka dhënë fund sulmeve izraelite dhe as nuk ka siguruar çarmatimin e militantëve. Më shumë se 1.200 palestinezë dhe katër ushtarë izraelitë janë vrarë në Gaza që nga arritja e armëpushimit në tetor, sipas zyrtarëve shëndetësorë të Gazës dhe ushtrisë izraelite./REL

jasper jeffers

gaza

shba

## Sondazh

Poll

BOTA 13 SHTATOR 2026, 09:34

Kremlini sjell në front reliktet e një princi të shekullit të 14-të

## më të klikuarat

"Qepeni gojën"/ Debate për shkrimin e bashkisë, Rama përplaslet me banorët e Policanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj! Qytetarët largohen nga takimi

Nga "Taken" te Thethi/ TikTokeri, me 4 milionë ndjekës, që i tregoi botës një Shqipëri tjetër

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë

Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendngjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia

## insights

Ola Xama  
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari  
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka  
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi  
REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

## Moti

Powered by  tomorrow.

Aktualitet

8 Shtator 2026, 18:34

## Protestuesit godasin me vezë makinën e deputetes Ilva Gjuzi/ Shoqërohen nga policia Adriatik Lapaj dhe Shpend Gashi (VIDEO)

Demis TITUBAKA - Qytetarët e rrugës protestojnë atëherë kur

Pamje TIRANË- Qytetarët po vijojnë protestën e tyre para ambienteve të Kuvendit, ndërsa seanca plenare ka përfunduar. Situata...

### EMRAT/ Të shtëna me armë zjarri në Has, plagoset 29-vjeçari, identifikohet autori

Aktualitet

8 Shtator 2026, 18:27

### A do të mbyllet konstituimi i Kuvendit më 9 shtator?

Aktualitet

8 Shtator 2026, 18:21

### Vatër zjarri në Rras të Lezhës, flakët përhapen drejt banesave

Aktualitet

8 Shtator 2026, 18:02

### U arrestua nga policia gjatë protestës/ Protestuesi: Kisha blerë vezë...

Aktualitet

8 Shtator 2026, 18:02

Aktualitet

8 Shtator 2026, 17:53

## VIDEO/ Po mbante vezë në duar, policia shtrin përtokë protestuesin dhe e shoqëron në komisariat

Pamje TIRANË- Kuvendi ka nisur ditën e sotme seancën e parë për sesionin e ri parlamentar. Njëkohësisht, qytetarët ...

### VIDEO/ Tensione tek Ushtari i Panjohur, protestuesit gjuajnë me vezë: Nuk na nërfacësoni

## Protesta para Kuvendit/ Qytetarët i bëjnë thirrje SPAK: Arrestoni Ramën!

Aktualitet  
8 Shtator 2026, 17:28


## Vatër zjarri në Drapata të Librazhdit, rrezikohet një banesë, ndërhyjnë zjarrfikëset

Aktualitet  
8 Shtator 2026, 17:20

## VIDEO/ Tensione jashtë Parlamentit, Policia shoqëron 2 protestues, momenti kur 'Shqiponjat' i mbërthejnë

Aktualitet  
8 Shtator 2026, 17:14

### MË SHUMË



Përplasjet e Ramës me banorët e Poliçanit, qytetari: U soll si sulltan, u tha qepeni gojën

Dita e 106-të e protestës/ Nis marshimi drejt Kryeministritë: Shqipëria kërkon revolucion

Rama në Berat: Çfarë lidhje ka distanca?, ndryshon vetëm drejtimi vendor

Digjet një banesë në lagjen Kastriot të Fushë-Krujës, shkak një luhajtje e energjisë elektrike

Përplasjet e Ramës me banorët e Poliçanit, qytetari: U soll si sulltan, u tha qepeni gojën

▶ Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

AKTUALITET  
POLITIKE  
EKONOMI  
BOTA

Drejtor: Enton Abilekaj  
Kryeredaktor: Izmir Akulli  
Gazetarë:  
Esmeralda Doçi

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444  
Email: [email protected]



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MBULIMET E ARTEFAKTIT Mediodesk

**SPORT**  
**ART&ARGËTIM**  
**INSIGHTS**  
**EDITORIAL**

Emanuela Dida  
Elisa Karaj  
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.